



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 113/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Suharekë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Suharekë, për shkak të vendosjes së posterave në shtyllat e ndriçimit publik, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 04.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

PZAP-i, me datën 03.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV dega Suharekë në të cilën theksohet se me datën 02.06.2014 aktivistët e LVV-së në Suharekë kanë vërejtur se në shtyllën e ndriçimit publik ishte i vendosur posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik AAK Naim Qelaj. Këto veprime sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së dhe me Rregullat Zgjedhore. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografimin nga vendi në të cilin pretendon se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të LVV-së janë të pabazuara pasi që nga fotografia e ofruar si dëshmi nuk mund të vërtetohet se posteri i kandidatit të AAK-së është i vendosur në shtyllën e ndriçimit publik, konkretisht nuk mund të vërtetohet ajo për të cilën pretendon pala ankuese në ankesën e saj.

PZAP-i në mungesë të provave lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë konstatoi se një pretendim i tillë ankimor është i pa bazuar dhe i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi biundëse, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 113/2014 më datën 04.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*